



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

## **Study program    Financa dhe kontabilitet (2017/2018)**

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Titulli	Magjistër i shkencave ekonomike - Drejtimi: Financa dhe kontabilitet
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-621/4
Vendimi për fillim me punë	03-1619/20 (18.12.2017)
Data akreditimit	21.03.2017

## **Përshkrimi i programit**

Qëllimet e programit janë:

- Ngritja e nivelit të administrimit dhe të udhëheqjes së ndërmarrjes dhe zhvillimi i menaxhmentit bashkëkohor;
- Aftësimi dhe ndërtimi i menaxherëve të profilit bashkëkohor: sipërmarrës, të gatshëm të ndërmarrin aksione, por edhe rreziqe të cilat ndërlidhen me çdo iniciativë, fleksibile, persona të vendosur dhe të guximshëm;
- Arsimimi i menaxherëve me kualifikim të lartë dhe profesionistë me aftësi lideri dhe dëshira për t'u ballafaquar me sfidat e mileniumit të ri;
- Krijimi i menaxherëve me pikëpamje të reja dhe me mënyra, po ashtu të reja, të të menduarit, zhvillimi i aftësive për parashikimin e të ardhmes dhe pranimi i sfidave dhe mundësive, të cilat i ofron biznesi në shekullin 21.

## **Karriera**

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:

- Të punojnë në mënyrë individuale dhe në grupe në hulumtimin e formave më përkatëse për plotësimin e nevojave të popullatës,
- T'i elaborojnë dallimet dhe nevojat e bashkësisë, nga aspekti shkencor dhe profesional.
- Të marrin pjesë aktive në ndërtimin e politikës makroekonomike dhe mikroekonomike.
- Të informohen dhe të kontribuojnë në elaboratet shkencore dhe profesionale.

## **Rezultatet e të mësuarit**

### **Njohuritë dhe të kuptuarit**

- Llogaritja e agregatëve themelorë makroekonomikë dhe analiza kritike e politikave aktuale makroekonomike.
- Dhënia e mendimit kritik për politikat zhvillimore dhe aplikimi i tyre në ekonominë kombëtare.

### **Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit**

- Aftësi për të diagnostifikuar zhvillimet aktuale të tregut, parashikimi i tendencave të këtyre zhvillimeve dhe analiza e

efekteve dhe e masave të politikës ekonomike mbi lëvizjet e tregut.

### **Aftësitë për të vlerësuar**

- Të jenë në gjendje të përfshihen në pozita udhëheqëse në organizatat fitimprurëse dhe jofitimprurëse në vend dhe nëpër botë.
- Analiza e proceseve të përgjithshme të zhvillimit ekonomik në botë dhe veçanërisht në proceset e tranzicionit, rajonalizimit dhe globalizimit të trendeve botërore ekonomike.

### **Aftësitë e komunikimit**

- Mundësia e zhvillimit të aftësive personale, komunikimit, hulumtimit dhe fitimi i aftësive të tjera të rëndësishme të cilat janë të nevojshme për punësim.
- Mundësia që studentët të angazhohen në mënyrë aktive në ligjërata dhe të kryejnë hulumtime të pavarura në të gjitha fushat e biznesit dhe ekonomisë.

### **Aftësitë e të mësuarit**

- Zhvillimi i konceptit i mendimit kritik të studentëve.
- Mundësia e përvetësimit të aftësive hulumtuese dhe përvojës për menaxhim, marketing dhe financa publike, në organizatat private dhe jofitimprurëse.

## **Lista e lëndëve**

### **Semestri 1**

- [MCBA1018] [6.0 SETK] **Financat për menaxherë**
- [MCBA1011] [6.0 SETK] **Ekonomia e avancuar**
- [MCBA1019] [6.0 SETK] **Menaxhementi strategjik i avancuar**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

### **Semestri 2**

- [MCFA2012] [6.0 SETK] **Financat e korporatave**
- [MCBA2013] [6.0 SETK] **Kontabiliteti financiar i avancuar**
- [MCBA2014] [6.0 SETK] **Financat ndërkombëtare të avancuara**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

### **Semestri 3**

- [BE0101] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [MCBA1014] [6.0 SETK] **Ekonomia monetare**
- [EMFA2014] [6.0 SETK] **Menaxhimi i portfolit dhe menaxhimi i riskut**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

### **Semestri 4**

- [MCFA4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

## **Description of courses**

### **Lëndë obligative**

- **Financat për menaxherë**  
Lënda ka për qëllim t'u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe praktike në fushën e menaxhimit me financa të subjekteve afariste. Lënda ofron një afërsi të mjaftueshme të studentit (si menaxher potencial) me informacionet

financiare me qëllim t'u mundësojë atyre analizimin dhe interpretimin e raporteve financiare si dhe marrjen vendimeve të mundshme investive dhe financiare. Gjithashtu kjo lëndë ka për qëllim edhe të zhvillojë shkathtësi të vlerësimit të subjekteve afariste, të menaxhimit me forma të ndryshme të financimit të veprimtarisë afariste si dhe parashikimin dhe vendimmarrjen investuese tani dhe në të ardhmen.

- **Ekonomia e avancuar**

Kjo lëndë përbëhet prej dy pjesëve: mikroekonomisë dhe makroekonomisë. Në mikroekonomi studiohet sjellja e konsumatorit në kuadër të ekzistimit të buxhetit të kufizuar dhe funksionimit të tij të plotë – maksimalizimi i shfrytëzueshmërisë, sjellja e ndërmarrjes në strukturat e ndryshme tregtare dhe roli dhe funksioni i tyre – maksimalizimi i profitit. Në mikroekonomi studiohen edhe faktorët dhe çmimet e tyre dhe roli i shtetit në rregullimin e bizneseve dhe të segmenteve të pasuksesshme të tregut. Makroekonomia e studion funksionimin e ekonomisë në tërësi. Në këtë kontekst vëmendja është fokusuar në madhësitë më të rëndësishme makroekonomike: në prodhimin bruto të vendit, në inflacion, papunësi, kursim, investime, kursin devizor e kështu me radhë. Vëmendje e posaçme u kushtohet faktorëve të cilët e prishin baraspeshën makroekonomike në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe natyrës e karakterit të politikave të rëndësishme makroekonomike, nëpër të cilat tentohet që prodhimi bruto faktik i vendit të afrohet aq sa është e mundshme me lëvizjen e prodhimit bruto potencial të vendit.

- **Menaxhementi strategjik i avancuar**

Qëllimi i lëndës në studimet postdiplomike është që studentët t'i thellojnë njohuritë e tyre në fushën e menaxhmentit strategjik, nëpërmjet analizave konkrete të ngjarjeve në Republikën e Maqedonisë dhe në vende të tjera të botës. Në këtë drejtim lënda ka për qëllim që t'i përpunojë në mënyrë më të hollësishme të gjitha temat më relevante në drejtimin e menaxhmentit strategjik si dhe ato të plotësohen edhe me shembuj praktik nga organizata të ndryshme të biznesit.

- **Financat e korporatave**

Lënda paraqet mundësi që studentët t'i thellojnë njohuritë e tyre nga kjo sferë. Me këtë rast, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet këtyre sferave: burimeve të financimit të firmave, strukturës së kapitalit, financimit të punës rrjedhëse, financimit të investimeve, politikës financiare, analizës financiare.

- **Kontabiliteti financiar i avancuar**

Qëllimi primar i kontabilitetit të avancuar financiar është përgatitja e raporteve kryesore financiare, si: bilanci i gjendjes, bilanci i suksesit, raporti i rrjedhës së parave, bilanci tatimor, me të cilat raporte pasqyrohet performanca operative e kompanisë në kuadër të një periudhe raportimi si dhe gjendja financiare në një moment të caktuar kohor. Këto raporte që përgaditen në aspekt kuartal ose vjetor janë në harmoni me SNK dhe SNRF dhe u adresohen palëve jashtë kompanisë duke i përfshirë investitorët, kreditorët, organet regullatore dhe autoritetet tatimore. Krahas përpilimit të raporteve kryesore financiare synohet të jepet edhe interpretimi kompetent profesional i të dhënave financiare në funksion të miratimit të vendimeve të drejta ekonomike.

- **Financat ndërkombëtare të avancuara**

Qëllimet e kësaj lënde janë që të sigurohet një hyrje në menaxhimin financiar ndërkombëtar dhe të debatohet se pse është me rëndësi të studiohen financat ndërkombëtare, sidomos kur është fjala për dallimin midis financave ndërkombëtare dhe atyre vendore. Lënda njëherësh prezanton llojet e ndryshme të sistemeve monetare ndërkombëtare, sipas të cilave ekonomia globale mund të punojë dhe të funksionojë në kohë të ndryshme. Përveç kësaj, programi i lëndës unioni monetar evropian, do ta trajtojë edhe konceptin e bilancit të pagesave dhe të kontabilitetit. Lënda gjithashtu ofron një pasqyrë të menaxhimit korporativ në botë. Struktura e menaxhimit qeverisjes korporativ ndryshon shumë nga vendi në vend. Ajo reflekton diversitetin e sistemeve kulturore, ekonomike, politike dhe ligjore.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Kjo lëndë fokusohet në një spektër të gjerë të metodave të studimit, të cilat mund të shfrytëzohen në kuadër të të gjitha shkencave shoqërore. Vëmendje u kushtohet metodave sasiore, po ashtu edhe cilësore të studimit. Kjo lëndë u dedikohet atyre të cilët kanë nevojë për zbatimin e hulumtimeve shoqërore, si pjesë e studimeve të tyre akademike.

- **Ekonomia monetare**

Lënda përfshin konceptet dhe politikat themelore monetare, zhvillimin e kornizës monetare, analiza makroekonomike dhe monetare dhe shfrytëzimi i analizës regresive, por edhe tregjet dhe institucionet financiare. Ky kurs duhet t'u ndihmojë studentëve (në aspektin konceptual dhe metodologjik) t'i analizojnë politikat e ndryshme monetare, lidhjen midis agregateve monetare dhe virabileve makroekonomike, si dhe rolin e institucioneve të ndryshme monetare dhe

financiare në procesin e ofertës së parasë.

- **Menaxhimi i portfolit dhe menaxhimi i riskut**

Ky kurs ofron njohuri dhe shkathtësi të avancuara në menaxhimin e portfolit dhe riskut. Lënda mbulon aspektet teorike dhe praktike nga identifikimi i riskut deri në menaxhimin e integruar të tij. Në këtë kontekst, demonstron konceptin e portfolit për diversifikimin e riskut, zgjedhja e letrave me vlerë, menaxhimi i portfolit, analiza e portfolit, derivatet financiare, etj.

- **Punimi i magjistraturës**

Pas dhënies së provimeve, studenti mund të fillojë me procedurën e paraqitjes, së punimit dhe mbrojtjes publike të temës së magjistraturës. Studenti zgjedh mentorin, me udhëzimin e të cilit e përgatit aplikimin e tezës së magjistraturës. Aplikimi patjetër duhet të lejohet nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit. Pas punimit të versionit final të tezës së magjistraturës, Këshilli mësimor-shkencor formon komision tre anëtarësh, i cili përgatit raport, me çka pranohet ose refuzohet teza e magjistraturës. Raporti pozitiv miratohet nga Këshilli mësimor-shkencor dhe caktohet dita e mbrojtjes publike. Pas kryerjes me sukses të mbrojtjes studenti pajiset me diplomë – Magjistër i shkencave ekonomike / Drejtimi: financë dhe kontabilitet.

## Lëndë zgjedhore

- **Statistika aplikative**

Përmes kësaj lënde studentët do t'i kuptojnë dhe do t'i zbatojnë elementet e statistikës deskriptive, teorinë e gjasës të ndjekur me gjasën dhe shpërndarjen e kopjeve, llogaritjen e parametrave shpërndarëse, llogaritjen dhe kontrollimin e hipotezave statistike, testimin e hipotezave, analizën e variantit, analizën lineare dhe analizën e serive kohore, regresionin dhe korrelacionin e thjeshtë linear.

- **Paraja dhe bankat**

Lënda mbështetet në aplikimin e analizave standarde ekonomike. Përbëhet nga studimi i teorive, nga modelet, politikat ndërkombëtare dhe përvojat ndërkombëtare. Qëllimi është aftësimi për t'i kuptuar dhe analizuar proceset e rritjes dhe zhvillimit. Kërkesat e mëparshme janë kurset e kryera nga makroekonomia dhe mikroekonomia, matematika dhe analiza sasiore. Njohja më e thelluar e disa disiplinave dhe subdisiplinave, siç janë: ekonomia aplikative, financat ndërkombëtare, ekonomia monetare, tregtia ndërkombëtare, financat ndërkombëtare, investimet etj. kompletohen dhe janë shumë të dobishme për përvetësimin e përmbajtjes së kësaj lënde.

- **Tregjet dhe institucionet financiare**

Studimi i kësaj lënde u mundëson studentëve t'i njohin parimet themelore të funksionimit të tregjeve financiare (tregun e parave, të kapitalit, tregjet revizore etj.) dhe institucionet financiare (bankat, kompanitë e sigurimit, fondet e pensionistëve, fondet e investimit), të cilat paraqesin një pjesë jashtëzakonisht të rëndësishme të çdo ekonomie kombëtare, si dhe të ekonomisë botërore në tërësi. Tregjet dhe institucionet financiare jo vetëm që ndikojnë në jetën tonë të përditshme, por, gjithashtu, merren edhe me transferimin e shumave të mëdha të mjeteve, të cilat pastaj ndikojnë në profitin e firmave, prodhimin e mallrave, të shërbimeve dhe të mbarëvajtjes së ekonomisë sonë dhe ekonomisë së huaj. Në dhjetëvjetëshin e fundit kanë ndodhur ndryshime fundamentale, ndryshime revolucionare të tregjeve dhe institucioneve financiare në korniza botërore. Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me drejtimet kryesore dhe me përmbajtjet e këtyre ndryshimeve. Por duke pasur parasysh faktin se është e sigurt se intensiteti i ndryshimeve nuk do të zvogëlohet në të ardhmen, kjo lëndë fokusohet që studentëve t'u sigurojë njohuri të atilla analitike, të cilat do të jenë të nevojshme t'i kuptojnë inovacionet financiare që me siguri të kenë nevojë, kur ata profesionalisht do të merren me biznesin financiar. Përvetësimi i njohurive nga kjo lëndë paraqet bazë për përsosje të mëtejshme të studentëve, të cilët presin dhe dëshirojnë të zënë ndonjë vend pune në grupin e gjerë atraktiv të sferave siç janë bankat, institucionet financiare në përgjithësi, financimi i korporatave, institucionet shtetërore dhe në aktivitetet afariste multinacionale, tregjet devizore dhe kreditore ndërkombëtare.

- **Analiza e raporteve financiare**

Lënda përfshin temat në vijim: bazat e analizës financiare, llojet e analizave financiare, kornizën e raporteve financiare, sistemin e raporteve financiare, raportet themelore financiare, fitimi kontabël dhe mjetet, analizat e rrjedhës së parasë, bazat e koeficientit dhe analizën financiare, analizën e mjeteve afatgjate, analizën e integruar, analizën e raporteve financiare, sintezat, analizën e strukturës së kapitalit.

- **Revizioni**

Kjo lëndë është menduar që t'u ofrojë studentëve njohuri themelore për aspektet konceptuale, teorike dhe praktike të

revizionit në mjedisin turbulent bashkëkohor. Realizimi i programit inspironet nga dëshira e studentëve, të cilët janë përcaktuar të studiojnë kontabilitetin dhe revizionin, t'u mundësohet që në vazhdimësi, me disiplinën e kontabilitetit t'i rrumbullakojnë njohuritë e fituara nga kontabiliteti dhe revizioni, të depërtojnë më thellë në fshhtësitë e profesionit të revizorit dhe të bëhen revizorë të suksesshëm në praktikë. Qëllimi kryesor i lëndës është të vihen në pah problemet kyçe, me të cilat ballafaqohet profesioni i revizorit në botë dhe tek ne në fillim të mileniumit të ri. Materia që do të përpunohet në kuadër të kësaj lënde i ndriçon fundamentet e profesionit të revizorit dhe ambientin në të cilin funksionon pa pengesë dhe në vazhdimësi, me fokusimin më të ngushtë të zbatimit të rregullativës profesionale, normave etike të veprimit profesional dhe rregullativës relevante ligjore. Në interes të përvetësimit sa më të lehtë të materies, studentëve u ofrohet një qasje komplekse, përkatësisht një qasje hap pas hapi e ndjekjes së procesit të revizionit nga faza initiale e kontraktimit të angazhimit, përmes planifikimit të aktiviteteve dhe zbatimit të procedurave për revizion deri në fazën finale – prezantimi i raportit të revizionit të realizuar. Konceptet fundamentale të revizionit: koncepti material, risku revizorial dhe dëshmitë e revizionit janë objekt i observimit të hollësishëm nga aspekti i implementimit të tyre në praktikën bashkëkohore të revizionit. Në studimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit intern, hap i parë inicial në zbatimin e revizionit është përkushtimi i vëmendjes së jashtëzakonshme.

#### • **Teoria e lojës**

Lënda synon ta përmirësojë aftësinë strategjike vendimmarrëse të studentëve në situata konkurruese në të cilën vlerësimi i tyre për rezultatin e një veprimi varet jo vetëm nga zgjedhjet që bëjnë ata, por edhe nga zgjedhjet e bëra nga të tjerët. Ne përqendrohemi në një metodë analitike e cila rrjedh nga teoria e lojës dhe e cila ofron një kornizë rigoroze analitike për strukturimin e situatave konkurruese, identifikimin e alternativave, duke zgjedhur mes tyre. Qasja themelore do të jetë thyerja e kompleksitetit në copa, përdorimi i mjeteve lojëra teorike për të analizuar pjesët dhe pastaj grumbullimi i pjesëve në një kuptim logjik koherent. Qëllimi ynë është që studentët të bëhen krijues më të mirë strategjikë vendim-marrës kur të përballen me sfidat konkurruese. Objektivat tona kryesore do të jenë përdorimi i koncepteve të teorisë së lojës dhe i mjeteve për identifikimin, diagnostifikimin dhe analizimin e sfidave konkurruese me të cilat përballen firmat në industri dinamike dhe zbatojnë konceptet e teorisë së lojës dhe mjetet e zhvillimit të strategjive për përparësinë konkurruese. E gjithë kjo do të bëhet duke analizuar lojëra të ndryshme.

#### • **Ekonomia urbane**

Kjo lëndë i njofton studentët me fuqitë ekonomike, të cilat e formësojnë zhvillimin e mjediseve urbane dhe të metropoleve. Lënda shqyrton atë se pse qytetet ekzistojnë dhe pse të gjitha qytetet nuk zhvillohen me ritëm të njëjtë. Përveç kësaj analizohen edhe aspekte, si p.sh. varfëria, segregacioni, kriminaliteti dhe ndotja e mjedisit jetësor.

#### • **Kontabiliteti në sektorin publik**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i ndihmojë studentët në të kuptuarit e rolit dhe rëndësisë së sistemit kontabël në sektorin publik. Në kuadër të kësaj lënde do të sqarohet qasja në raportimin financiar, me theks të veçantë në bazat metodologjike të parimeve të kontabilitetit dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik, raportimin financiar të qeverisë për krahasim ndërkombëtar në përputhje me sistemin e llogarive kombëtare dhe sistemin e statistikave financiare shtetërore, kontabilitetin e mjeteve dhe borxheve afatgjata, kontabilitetin e fondeve, buxhetin dhe kontabilitetin buxhetor dhe auditimin në sektorin publik.

#### • **Kontabiliteti i avancuar menaxherial**

Lënda kontabilitet i avancuar menaxherial synon t'u ofrojë studentëve njohuri të avancuara në lidhje me kontabilitetin e shpenzimeve dhe të menaxhimit në veçanti në lidhje me: përlllogaritjen, buxhetimin, kontrollin dhe evaluimin e qendrave të përgjegjësisë gjatë miratimit të vendimeve në funksion të zhvillimit të kompanisë. Qëllimi më specifik i kësaj lënde do të jetë përcaktimi i kostos për të hyra të veçanta në situata specifike në kuadër të konceptit të punës së porositur, Procesit të prodhimit dhe alokimit të kostove indirekte me metodën ABC. Në menyrë specifike do të aplikohet koncepti i kostos oportune në situata kur vendoset në bazë të informatave relevante dhe konceptit të pikës kritike të rentabilitetit në funksion të miratimit të vendimeve të drejta ekonomike.

#### • **Ekonomia e investimeve**

Lënda ekonomia e investimeve u mundëson studentëve të fitojnë njohuri dhe shkathtësi adekuate të sferës së investimeve në subjektet afariste dhe të investimeve publike në nivel qeveritar. Lënda ka për qëllim t'i pajisë studentët me njohuri dhe praktika me çka ata do ta kuptojnë ndërlidhjen e investimeve me rritjen e aktivitetit afarist të NVM dhe njëkohësisht të rritjes dhe zhvillimit ekonomik, kuptimin e procesit investiv dhe vendimmarrjeve investive. Mëtej lënda ka për qëllim t'i pajisë studentët me njohuri të avancuara drejt një analize financiare të projekteve investuese në plan mikro dhe atë makro. Me mbarimin e kësaj lënde studentët do të aftësohen të punojnë si menaxherë të aftë për të sjellë vendime përkatëse investive në dobi të subjekteve afariste ku ato do të punojnë.

#### • **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimimin e shumë gjërave, por

sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlihet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qëndrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari i përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termat: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuara nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Tregu i punës**

Qëllimi kryesor i lëndës "Tregu i punës" është t'i pajisë studentët e studimeve të ciklit të dytë me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë të tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda "Tregu i punës" ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale të cilat mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj studenti, për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme që lidhen me tregun e punës.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxëniet si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe

strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Filozofia e shkencave shoqërore**

Kjo lëndë përfshin pajisjen e studentëve me informata që do t'u mundësojnë atyre përfitimin e diturive, shkathhtësive dhe kompetencave në shkencat shoqërore, përfshirë metodologjinë e punës (sqarim, teoretizim, testim), aplikim të filozofisë (në veçanti individualizmi kundrejt kolektivizmit), natyra e racionalitetit, si dhe historia e teorive dhe koncepteve. Ky modul ofron studim të avancuar të debateve aktuale lidhur me ontologjinë, metodologjinë dhe synimet e shkencave shoqërore. Lënda do të përqendrohet në çështjet qendrore të shkencave shoqërore: etno-metodologjia, evolucioni, fenomenologjia, racionaliteti, relativizmi, metodat shkencore, interpretime tekstuale. Rezultat e të mësuarit: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Ta kuptojnë qëllimin e shkencave shoqërore si dhe dallimin në mes të të sqaruarit dhe të kuptuarit të sjelljes njerëzore. T'i sqarojnë qasjet e ndryshme në shpjegimin e shkencave shoqërore në krahasim me shkencat shoqërore, specifikat e të qenit qenie njerëzore dhe fenomenet sociale. T'i kuptojnë strukturat sociale, praktikat, normat institucionet etj. si dhe relacionet në mes individëve dhe strukturave më të gjera shoqërore. Ta sqarojnë mbështetjen jo vetëm në fakte për individët dhe gjendjet e tyre mentale, por gjithashtu edhe rastet në të cilat fenomenet shoqërore nuk mundet të sqarohen përmes sjelljeve individuale.

- **Menaxhimi i projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; Të strukturojnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikat e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisë të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe e drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: Të zhvillojë kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do i marrin parasyshtë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.